

Dua të jem pjesë e një kisha

Mirë se erdhe në festimin e kishës sonë!

Mesazhi sot ka një theks të veçantë te familja, por në një nivel më të gjerë, te familja e Perëndisë që është kisha. Në momentin që ti zgjedh të besosh, Bibla thotë që ti bëhesh bir/bijë i Perëndisë.

Dhe te **Efesianëve 1:5** thuhet: *'duke na paracaktuar që të birësohemi në veten e Tij me anë të Jezu Krishtit, sipas pëlqimit të vullnetit të vet,'*

E gjithë Bibla tregon se Perëndia ka qenë dhe është duke ndërtuar një familje që nuk do të ekzistojë vetëm këtu mbi këtë tokë, por do të jetë e përjetshme sepse jemi krijuar për të qenë të përjetshëm. Ja si thotë një varg tjetër në Bibël.

1 Pjetrit 2:17 *'Nderoni të gjithë, doni vëllazërinë, druani Perëndinë, nderoni mbretin.'*

"Doni vëllazërinë," ose e thënë ndryshe: *"Doni familjen tuaj frymërore!"*. Ja se çfarë kërkon Perëndia nga ne. Ai do që ne të mësojmë të duam njëri-tjetrin, të mësojmë të jemi pjesë e kësaj familjeje. Dhe ka disa arsye pse Ai na e kërkon këtë gjë.

Së pari: na bën më shumë të ngjashëm me Perëndinë, sepse Perëndia është dashuri.

Së dyti, Ai dëshiron që fëmijët e Tij (bijtë dhe bijat e Tij) të merren vesh me njëri-tjetrin.

Së treti, kjo është një lloj faze përgatitore për përjetësinë. Sepse do të jemi përjetësisht bashkë. Kur dikush thotë, "Unë nuk i kam qejf të krishterët," ka mundësi që nuk do t'i pëlqejë as qielli, sepse do t'i ketë aty, dhe do t'i ketë përjetësisht ashtu. Dhe Perëndia dëshiron që ne të fillojmë ta praktikojmë që këtu këtë gjë.

Këto fjalë, vëllazëria, bashkësia, Bibla i përdor për të përshkruar dashurinë për njëri-tjetrin. Bibla na thotë:

1 Gjonit 4:21 *'Dhe ky është urdhërimi që kemi marrë nga ai: ai që do Perëndinë, të dojë edhe vëllanë e vet.'*

Ne duhet t'i duam besimtarët e tjerë. Si do ta realizojmë këtë? Bibla na jep udhëzime të qarta si kristali. Pali shkroi:

1 Timoteut 3:14-15 *'Po t'i shkruaj këto gjëra duke shpresuar që të vij së shpejti te ti, por, po u vonova, të dish se si duhet të sillesh në shtëpinë e Perëndisë, që është kisha e Perëndisë së gjallë, shtylla dhe mbështetja e së vërtetës.'*

Ishte fjala **shtëpi** dhe fjala **kishë**. Qe i bie kisha në të vërtetë është një shtëpi, një familje. Nuk është as **ndërtesë**, as **institucion**, as **organizatë**, është familje.

Thënie: Kisha nuk është një vend ku ti mund të shkosh, ajo është një familje, të cilës ti mund t'i përkasësh. Është një familje të cilës i përket.

Le të shohim katër nivele të bashkësisë apo vëllazërisë në familjen e Perëndisë.

Niveli i parë i Bashkësisë--Vëllazërisë: Anëtarësia

Pra, gjëja e parë është të vendosësh: “Unë do të bëhem pjesë e familjes së Perëndisë!” E thënë më thjeshtë: Gjej një kishë që të pëlqen, që shkon me gjërat që ti vlerëson dhe ëndërron, dhe vendos të bëhesh pjesë e asaj kishë. Shiko se çfarë thotë Bibla rreth kësaj gjëje.

Efesianëve 2:19 *'Ju, pra, nuk jeni më të huaj, as bujtës, por bashkëqytetarë të shenjtorëve dhe pjesëtarë të familjes së Perëndisë,'*

Jeni pjesëtarë të një familjeje. Jeta e krishterë nuk është vetëm besim, por edhe përkatësi. Është zgjedhja jote t'i përkasësh familjes së Perëndisë. Dhe Perëndia dëshiron që ti ta bësh këtë zgjedhje sa më parë. Herë pas here dëgjoj të krishterë që thonë: “Unë jam i krishterë, por në fakt nuk dua t'i përkas ndonjë kishë.”

Duket si deklaratë e pranueshme, por në fakt s'ka kuptim. Sepse jeta e krishterë mund të jetohet e plotë vetëm brenda familjes së Perëndisë. Është njësoj sikur një futbollist të thotë: “Unë jam futbollist dhe e kam shumë qejf futbollin, por nuk kam qejf të jem pjesë e ndonjë skuadre futbollit.”

Duket pa logjikë. Nuk funksionon ashtu futbollit. Krishtërimi, ashtu si dhe futbollit, është një lloj sporti që luhet në skuadër. Një i krishterë që nuk është pjesë e një kishë është si i pastrehë, si jetim, pa familje, sepse qëllimi i Perëndisë është të jesh pjesë e një familjeje. Bibla na thotë diçka rreth kësaj

Romakëve 12:5 *'kështu edhe ne, megjithëse jemi shumë, jemi një trup në Krishtin dhe secili jemi gjymtyrë të njëri-tjetrit.'*

Ka besimtarë që shkojnë nga një kishë te tjetra; për njëfarë kohe s'ka gjë, është në rregull. Por nëse dëshiron të rritesh, nëse dëshiron të shohësh Perëndinë të veprojë në jetën tënde, duhet t'i bashkohesh një trupi, një familjeje, dhe të bëhesh pjesë e ngjarjeve në atë grup.

Jezusi e quan kishën trupin e Tij. Imagjinoni t'i thoni një vajze: “Të kam fiks... po trupin se ke gjë!” Me siguri do të hani në ndonjë syve. Jezusi e do kishën. Kisha është nusja e Krishtit, na thotë Bibla. Imagjinoni dikë që thotë: “Ti je shumë e mirë, por nusen tënde nuk e shoh dot me sy.” Kujt nga të martuarve do t'i pëlqente kjo?

Në fakt, ekziston një simbol kur një person i përket familjes së Perëndisë. **Është pagëzimi.** Pagëzimi është simboli që tregon se një person i përket familjes së Perëndisë. Është mënyra publike për të shpallur, “Unë besoj te Jezusi Krishti si Zot dhe Shpëtimtar, s’kam turp dhe jam pjesë e një grupi besimtarësh, dhe unë jam shumë i gëzuar për këtë gjë.”

Ashtu si unaza është simbol i përkushtimit ndaj bashkëshortit apo bashkëshortes, ashtu edhe pagëzimi është një simbol i qartë i përkushtimit ndaj Jezus Krisht.

Pra, niveli i parë i përkushtimi tënd, është zgjedhja për të qenë pjesë e një familjeje besimi. Niveli i dytë i bashkësisë apo vëllazërisë është pak më i thellë, është një hap më tej brenda familjes së Perëndisë.

Niveli i dytë i Bashkësisë: Të Mësojmë Të Ndajmë

Bibla thotë: **Veprat 2:44** *'Por gjithë ata që besonin rrinin bashkë dhe çdo gjë e kishin të përbashkët.'*

Dy gjëra; “**rrinin bashkë**” dhe “**çdo gjë e kishin të përbashkët**”. Nga këtu dalin dy mësimet të rëndësishme. Ti nuk mund të rritësh miqësinë pa “**ndenjur bashkë**” dhe së dyti, ti nuk mund të rritësh miqësinë nëse nuk “**ndan gjërat**” me dikë tjetër.

Sa më shpesh takohesh me dikë, aq më e afërt do jetë marrëdhënia jote me të.

A të bëjnë përshtypje ata njerëz që kanë miqësi apo shoqëri të fortë me njëri-tjetrin? Shpesh i kemi zili dhe mendojmë se janë me fat që kanë njëri-tjetrin dhe janë aq të lidhur. Por në fakt, nuk është fare çështje fati. Është çështje zgjedhjeje. **Është zgjedhja jonë për ta zhvilluar ose jo miqësinë, dhe mënyra më e mirë është duke investuar kohën tonë në të.**

A e dini se ka njerëz të vetmuar? Jo se nuk kanë pasur fat, por se nuk kanë investuar kohë për të zhvilluar miqësitë e tyre. Nuk është fare çështje fati, është thjesht zgjedhje që bëjmë.

Ne nuk do mund të zhvillojmë miqësi pa ndarë gjërat tona me të tjerët. Vargu më lart thoshte: “*dhe çdo gjë e kishin të përbashkët.*”.

Kush ka fëmijë e di që një nga gjërat e para që i mësojmë fëmijës është të ndajë gjërat me fëmijët e tjerë.

Pikërisht këtë gjë kërkon edhe Perëndia nga ne: “*Të mësojmë të ndajmë gjërat me të tjerët*”. Se mësojmë kalamajtë por harrojmë ta praktikojmë kur rritemi. Por çfarë duhet të ndajmë në fakt? Bibla jep plot detaje se çfarë të ndajmë me të tjerët, ja tre gjëra:

Ndajmë PËRVOJAT tona

Bibla thotë që mësojmë nga njëri-tjetri. Le të shohim këtë varg:

Fjalët e Urta 27:17 *'Hekuri mpreh hekurin, kështu njeriu mpreh fytyrën e shokut të tij.'*

Tani, mësojmë nga gabimet dhe përvojat tona, por është shumë më mirë nëse mësojmë nga përvojat dhe gabimet e të tjerëve. Pse? Nëse ke vendosur që çdo gjë në jetë ta mësosh nga gabimet e tua, do kesh një jetë plot me shqetësime dhe probleme që fare lehtë mund t'i kishe mënjanuar. Jeta është shumë e shkurtër për të mësuar çdo gjë nga gabimet që bëjmë vetë. Nëse unë bëj një gabim dhe nxjerr mësim nga ai gabim, ti nuk ke nevojë të bësh të njëjtin gabim.

Siç thotë një fjalë e urtë shqiptare: “Kush mësoi pa pësuar?” Le ta ndryshojmë këtë fjalë të urtë, le të mësojmë nga njëri-tjetri pa pësuar, se kështu i kursejmë vetes disa dhimbje koke të panevojshme.

Pra, të kalojmë kohë së bashku, të mësojmë nga njëri-tjetri kur ndajmë përvojat tona. Çfarë ndajmë tjetër?

Ndajmë SHTËPITË tona

1 Pjetrit 4:9 *'Jini mikpritës njëri për tjetrin...'*

Hapim shtëpitë për njëri-tjetrin. Po përse e thotë Perëndia këtë, që të jemi mikpritës? Pse duhet të hapim shtëpitë tona për njëri-tjetrin? Është fare e thjeshtë.

Ti nuk mund të kesh bashkësi të thellë në një grup të madh, në festimin e të dielës. Këtu në festime mund të adhurojmë Perëndinë bashkë, mësojmë nga Fjala e Tij, festojmë për gjërat që Ai ka bërë për ne, por është praktikisht e pamundur të zhvillojmë miqësi të thella në këto festime.

Bashkësia me njëri-tjetrin mund të thellohet në grupet e vogla. Atje mund ta njohim më mirë njëri-tjetrin. Diçka shumë interesante: **A e dini se gjatë 300 viteve të para të historisë së kishës nuk ekzistonin godinat e kishave?** Të gjitha takimet e kishës bëheshin nëpër shtëpi, dhe në shumë pak vende takoheshin në një vend të veçantë që nuk ishte shtëpia e dikujt. Deri në vitin 300, nuk kishte ndërtesa kishash. Dhe një fakt tjetër: ajo ka qenë periudha me rritjen më të shpejtë në historinë e kishës.

Prandaj është kaq e rëndësishme që të mblidhemi së bashku në grupet e vogla, mundësisht në shtëpitë tona, apo në ndonjë kafene.

Bashkësia—vëllazëria e vërtetë është kështu: ndajmë shtëpitë bashkë, ndajmë jetët bashkë. Cila është tjetra?

Ndajmë HALLET--GEZIMET tona

Nuk kemi pse të përballemi vetëm me hallet dhe problemet tona. Bibla na thotë:

Galatasve 6:2 *'Mbani barrët e njëri-tjetrit dhe kështu do të përmbushni ligjin e Krishtit.'*

Dikush ka thënë: *Kur ndan gëzimin tënd me dikë, dyfishohet. Kur ndan dhimbjen me dikë, përgjysmohet.* Bibla e thotë kështu:

Romakëve 12:15 *'Gëzohuni me ata që gëzohen, dhe qani me ata që qajnë.'*

Në fakt, kjo është ajo që duhet të ndodhë në grupet e vogla. Do të ketë raste kur do të qeshni së bashku, do të ketë raste kur do të mbani barrat e njëri-tjetrit së bashku, varet nga çfarë po kalon secili prej nesh.

A t'ju them diçka për ata që drejtojnë grupet e vogla, që të mos i zërë frika: *Nuk pritet nga ty që të zgjidhësh problemet e gjithsecilit. Perëndia nuk kërkon këtë nga ty. Ai kërkon që të ndash hallet e tua me të tjerët dhe të dëgjosh kur dikush ndan hallet e tij me ty.* Shpesh nuk kemi nevojë për dikë që të na japë zgjidhje, shpesh kemi nevojë për dikë që të na dëgjojë.

Asnjë nga ne nuk do të mund ta përjetojë dhe përmbushë këtë nivel të bashkësisë, pra të ndajmë çdo gjë me njëri-tjetrin, nëse nuk jemi pjesë e një grupi të vogël. Prandaj, Bibla thotë:

Hebrenjve 10:25 *'pa hequr dorë nga të mbledhurit bashkë tonin, sikurse kanë zakon disa, por të nxisim njëri-tjetrin, aq më tepër se e shihni ditën që po afrohet.'*

Qëllimi kryesor i grupeve të vogla është të inkurajojmë njëri-tjetrin. Unë uroj që të mos heqim kurrë dorë nga zakoni i të mbledhurit së bashku.

Niveli i tretë i Bashkësisë: Partneritet—Bashkëpunim

Partneriteti nënkupton që unë do të bëj pjesën time, do të jap kontributin tim; atë që familja e kishës sime ka nevojë që unë të bëj. E di çfarë: **Perëndia nuk të solli në këtë kishë vetëm për të nderur. Perëndia të solli këtu që të marrësh dhe japësh, të shërbesh.**

Ai dëshiron të bëjë gjëra nëpërmjet jetës tënde, të veprojë nëpërmjet teje në jetët e të tjerëve.

Si në çdo familje, edhe këtu ka përgjegjësi që duhen ndarë mes anëtarëve të familjes. Secili nga ne ka pjesën e tij. A e di se në Dhjatën e Re përmendet 58 herë togfjalëshi “njëri-tjetrit”? Ne duhet t’i shërbejmë njëri-tjetrit, ta duam njëri-tjetrin, të lutemi për njëri-tjetrin, e kështu me radhë. Është mirë të formosh miqësi me anëtarët e familjes frymërore, por është akoma më mirë të japësh kontributin tënd për mbarëvajtjen e saj. Ja si thotë Bibla:

1 e Korintasve 3:9 *'Ne, pra, jemi bashkëpunëtorë të Perëndisë...'*

Nëse marrim pjesë bashkë, ne bashkëpunojmë me njëri-tjetrin në familjen e Perëndisë, jemi pjesë e planit të Perëndisë për këtë qytet. Por për të qenë pjesë, duhet të gjesh vendin tënd. Bibla na thotë që secili nga ne ka vendin e tij. Ja si thuhet:

Efesianëve 4:16 *'Prej të cilit gjithë trupi, i lidhur mirë dhe i bashkuar, me anë të kontributit që jep çdo gjymtyrë dhe sipas forcës së çdo pjese të veçantë, shkakton rritjen e trupit, për ndërtimin e vetes së tij në dashuri.'*

Ne jemi pjesë e trupit të Krishtit. Dhe duke punuar së bashku do mund të realizojmë planin e Tij për këtë vend. Duke bashkëpunuar me njëri-tjetrin do arrijmë shumë më tepër se sa mund të arrijë secili prej nesh i vetëm.

Nënë Tereza e kaloi gjithë jetën e saj duke u shërbyer njerëzve të varfër në Kalkuta, Indi. E pyetën njëherë: *Si arrin të përballosh gjithë këto sëmundje dhe vdekje ditë pas ditë?* Përgjigjja e saj ishte: *"Në fytyrën e çdo personi që prek apo fashoj, imagjinoj fytyrën e Jezusit, dhe gjithçka e bëj për Të."* Ky është sekreti, kjo i jepte fuqi, si thuhet te:

Mateu 25:40 *'Dhe Mbreti duke iu përgjigjur do t'u thotë: "Në të vërtetë po ju them: sa herë ia keni bërë këtë ndonjërit prej këtyre vëllezërve të mi më të vegjël, këtë ma bëtë mua.'*

Bëjmë secili diçka dhe së bashku ndodh ajo që do Perëndia në këtë qytet.

Niveli i katërt i Bashkësisë: FAMILJA

Ky është niveli më i lartë dhe më i thellë i bashkësisë. Të duash besimtarët si anëtarë të familjes. Të jesh totalisht i përkushtuar ndaj tyre. Bibla thotë:

Romakëve 12:10a *'Duajeni njëri-tjetrin me dashuri vëllazërore...'*

Fjala origjinale në Greqishten e vjetër për bashkësinë është **“koinonia”**. Kuptimi i saj është të përkushtohemi ndaj njëri-tjetrit ashtu siç jemi përkushtuar ndaj Krishtit.

Ky është niveli më i thellë i bashkësisë me njëri-tjetrin. Të kesh një lidhje të tillë, si marrëdhënie familjare.

Ka mundësi që shumica prej nesh, apo të gjithë, e dimë se çfarë thotë **Gjoni 3:16** *'Perëndia aq shumë e deshi botën...'*

Por shumë pak e dinë se çfarë thotë **1 Gjoni 3:16** që është gjithashtu e rëndësishme.

1 Gjoni 3:16 *'Nga kjo e kemi njohur dashurinë: ai e dha jetën e vet për ne; dhe ne duhet ta japim jetën tonë për vëllezërit.'*

Ky është niveli më i thellë i bashkësisë: sakrifica për njëri-tjetrin. Këtë lloj dashurie tregoi Jezusi për ty duke vdekur në kryq.

Ky është thelbi i jetës tonë, të duam Perëndinë dhe të mësojmë të duam njëri-tjetrin. Nëse na shpëton kjo gjë, na ikën nga duart qëllimi i jetës tonë. Thelbi i jetës nuk janë arritjet, janë marrëdhëniet. Ti ke ardhur në këtë botë për të njohur Perëndinë dhe për ta dashur atë, për të njohur familjen e Tij dhe për ta dashur atë, sepse me këto dy do kalojmë përjetësinë, me Perëndinë dhe me njëri-tjetrin.

Besoj se në jetën tuaj keni përjetuar, apo nëpër filma keni parë, njerëz të moshuar duke vdekur. A keni parë ndonjëherë ndonjë prej tyre që në momentet e fundit thotë: *"Më sillni këtu gjithë diplomat e mia, gjithë dekoratat e mia. Më sillni atë orën e floririt se e kam blerë shumë shtrenjtë. Më sill certifikatën e shtëpisë ta shoh edhe një herë, m'i sill çelësat e makinës, ta tregoj edhe një herë telefonin e fundit që e pata blerë me pensionin e fundit."* A e keni hasur ndonjëherë këtë? Jo, asnjëherë.

Të gjithë kërkojnë diçka tjetër. Kush e di? *"Më sillni pranë familjen, miqtë."* Në fund të jetës, çdo person e kupton se gjëja më e rëndësishme në jetë ka qenë njeriu dhe marrëdhënia me të. Por, ne kemi shansin ta kuptojmë që tani se çfarë ka me të vërtetë rëndësi në jetën tonë.

Të duam Perëndinë dhe të duam njëri-tjetrin. Jezusi tha:

Gjoni 13:35 *'Prej kësaj do t'ju njohin të gjithë që jeni dishepujt e mi, nëse keni dashuri për njëri-tjetrin''.'*

Prej kësaj do t'ju njohin i gjithë qyteti, gjithë Shqipëria, gjithë bota, nëse e keni xhan njëri-tjetrin. Kjo është shenja dalluese.

Fare pak kohë pasi Jezusi tha këtë, të krishterët e parë në Romë filluan të persekutohen dhe madje të hidhen te luanët në Koloseun e famshëm. Në këtë periudhë, një nga historianët e asaj kohe shkruante kështu për të krishterët:

“I shoh dhe më bën përshtypje se sa shumë e duan njëri-tjetrin këta të krishterët.”

Po sikur ne si kishë të njihemi në qytet, në Shqipëri, mes gjithë shqiptarëve, jo për madhësinë e kishës, jo për mesazhet e mira, jo për muzikën e papame, jo për strategjitë e ungjillizimit apo për godinën e bukur, por për dashurinë tonë për njëri-tjetrin?

Po sikur të jetë aq e njohur, aq e dukshme saqë njerëzit të thonë: “Ne në kishë e duam njëri-tjetrin, madje dhe vizitorët”?

Në çastin që kisha jonë do arrijë këtë nivel pjekurie dhe këtë nivel dashurie, njerëzit do të vërshojnë si lumë drejt kishës. Sepse njerëzit jashtë janë duke kërkuar për një familje të tillë; janë duke kërkuar këtë lloj dashurie të sinqertë që vjen prej lart.

Si mbyllje, le të shohim ku jemi sot. Në cilën fazë ndodhemi.

Nëse është dikush sot këtu që nuk është akoma pjesë e kishës por që dëshiron të jetë, sot është dita e duhur. Tako njërin nga ne, mua, (emra të personave të kishës që mund të takojnë të rinjtë) _____, _____.

Të gjithë besojmë se kemi nevojë të mësojmë të ndajmë gjërat tona dhe të forcojmë miqësitë tona. Bëhu pjesë e një grupi të vogël; aty është ambienti i duhur për të ushqyer marrëdhëniet tona. Që tani, vendos: “Unë do të vazhdoj të jem pjesë e grupeve të vogla” nëse ke qenë, ose “Unë do të filloj një grup të vogël ose do të jem pjesë e një grupi” nëse nuk ke qenë. Fol me _____, _____, ose me mua.

Nëse je i gatshëm të shërbesh je shumë i mirëpritur. Mundësi ka shumë dhe ne do të të ndihmojmë të gjesh vendin tënd.

Nëse do të pagëzohesh, fol me _____.

Nëse do të besosh sot për herë të parë:

Lutja e shpëtimit.

Le të lutemi.

